

ASC-10-0009

Në padinë e

1. [REDAKTUAR]

2. [REDAKTUAR]

që të dy nga fshati [REDAKTUAR], Ferizaj, përfaqësuar
nga [REDAKTUAR], Avokat në Ferizaj

Paditësit / Ankuesit

kundër

1. [REDAKTUAR], NSH

Ferizaj

2. Komuna e Ferizajt

Të Paditurit

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Mr.sc.Sahit Sylejmani, Gjyqtarë, në ankesën e Paditësit kundër aktvendimit të Trupit Gjykses të DHPGJS-së të datës 17 dhjetor 2009, SCC-09-0178, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 11 tetor 2010, jep këtë

AKTVENDIM

1. Ankesa hedhet poshtë si e pabazuar. Miratohet pika 1 e aktvendimit të Trupit Gjykses të datës 17 dhjetor 2009, SCC-09-0178.
2. Me rastin e ankesës, hiqet pika 2 e aktvendimit të Trupit Gjykses të datës 17 dhjetor 2009, SCC-09-0178.

3. Ankuesit janë të obliguar bashkërisht që të paguajnë për Dhomën e Posaçme taksën gjyqësore në shumë prej 60 Euro.

Arsyet ligjore:

Me aktvendimin ndaj të cilit është ngritur ankesa Trupi Gjyqësor e refuzoi padinë për të drejtën e pronësisë të Paditësve si të papranueshme mbi bazat e nenit 28.4 të UA UNMIK-ut 2008/6, duke konsideruar se padia nuk i plotësonte kushtet e përcaktuara në nenin 28.2 (f) të UA UNMIK-ut 2008/6 (pasi që Paditësit nuk e dorëzuan përkthimin në gjuhën angleze të padisë dhe të të gjitha dokumenteve mbështetëse, pavarësisht nga urdhri i datës 2 tetor 2009 në të cilin tregohet mangësia dhe kërkohej plotësimi i padisë).

Në ankesën e tyre Paditësit (më tej Ankuesit) kërkojnë 'anulimin apo ndryshimin' e aktvendimit të Trupi Gjyqësor (dhe lejen për të kontrolluar dosjen gjyqësore të deponuar në DHPGJS). Ata pohojnë se kundrejt përfundimit të Trupit Gjyqësor përkthimi i duhur në gjuhën angleze veçse ishte paraqitur me padinë origjinale. Si pasojë, urdhri për sqarim i Trupit Gjyqësor i datës 2 tetor 2009 ishte "i paarsyeshëm dhe i paqartë", dhe aktvendimi i atakuar bazohej në fakte të pasakta.

Ankesa është ushtruar në kohë, por është e pabazuar; prandaj duhet të refuzohet.

Në bazë të nenit 28.2 (f) të UA UNMIK-ut 2008/6, padia është e pranueshme vetëm nëse:

"Parashtrësit janë paraqitur në përputhje me kushtet nga nenet 25 dhe 27 të kësaj Urdhërese Administrative."

Neni 25.7 i UA UNMIK-ut 2008/6 thotë:

"Parashtresat dhe dokumentet përcjellëse mund të paraqiten në gjuhën shqipe, serbe ose angleze. Por, nëse paraqiten në gjuhën shqipe ose serbe, duhet të sigurohet edhe përkthimi i të gjitha parashtresave dhe dokumenteve përcjellëse edhe në gjuhën angleze..."

Në fund, neni 28.4 i UA UNMIK-ut 2008/6 parashikon refuzimin e padisë si të papranueshme, nëse nuk është në pajtim me dispozitat e përmendura, dhe nëse nuk është plotësuar pas urdhrit të gjykatës.

Padia dhe dokumentet plotësuese janë dorëzuar vetëm në gjuhën shqipe. Gjithashtu, Ankuesit nuk kanë përmbushur urdhrin e Trupit Gjykses të datës 2 tetor 2009, pasi që as atëherë ata nuk kanë ofruar në DHPGJS përkthimin e kërkuar në gjuhën angleze.

Ankuesit nuk e kontestuan bazën faktike të marrjes të Trupit Gjykses (dokumentet përkatëse që janë dorëzuar vetëm në gjuhën shqipe) gjatë procedurës në shkallën e parë. Veçanërisht, ata nuk kanë dorëzuar një përgjigje në urdhrin e datës 2 tetor 2009, duke mos qenë në asnjë mënyrë 'i paarsyeshëm dhe i paqartë', në të cilën do të deklaronin se padia në fakt ishte ushtruar me dokumentacionin e duhur dhe përkthimin në gjuhën angleze. Megjithatë, ky do të kishte qenë rast i përshtatshëm për t'iu përgjigjur gjykatës, e cila e ka theksuar në mënyrë eksplicite se (sipas shkresave të lëndës) përkthimi në gjuhën angleze mungonte, dhe pasojat e mosplotësimit të padisë në përputhje me rrethanat brenda afatit të caktuar aty.

Kështu, aktvendimi i atakuar ishte në pajtim me ligjin. Argumentet e paraqitura nga Ankuesit në ankesën e tyre nuk e ndryshojnë këtë rezultat:

Si çështje parimore, faktet (duke përfshirë çështjet procedurale) që veçse ekzistonin / u ndeshën gjatë procedurës në shkallën e parë nuk mund të paraqiten në një ankesë kundër aktvendimit përfundimtar, nëse nuk ka pasur pengesa për ti paraqitur ato në shkallën e parë. Në lëndën në fjalë, Ankuesit janë përballur në mënyrë eksplicite me çështjen përmes urdhrit të datës 2 tetor 2009. Ata nuk u përgjigjën / sqaruan se ata (gabimisht) e konsideruan padinë si të përcjellë me përkthimin e duhur në gjuhën angleze.

Siç është përmendur më lartë, Ankuesit nuk mund ta ngrenë më këtë argument me ankesën, pasi që nuk ishte paraqitur gjatë procedurës së shkallës së parë. Ankesa nuk përmban argumente tjera; prandaj, duhet të refuzohet si e pabazuar.

Sa i përket ushtrimit të mundshëm të një padie krejtësisht të re (krahaso këshillën e Trupit Gjyqësor në fund të aktvendimit të atakuar), Ankuesit mund të konsiderojnë që të ofrojnë argumente tjera, në bazë të të cilave ata konsiderojnë se DHPGJS-ja ka juridiksion mbi të Paditurin e dytë (një komunë), dhe të sqarojnë lidhjen mes të Paditurit të parë dhe të dytë.

Pika 2 e aktvendimit të atakuar duhet të hiqet në rastin e ankesës, pasi që udhëzimet për të ushtruar ankesë duke cituar ligjin, pa ndonjë liri veprimi nga ana e gjykatës, janë që asnjë vendim nuk duhet të merret në dispozitiv. Informacionet e tilla mund të jepen me arsyet ligjore ose – më mirë – të bashkëngjiten vetëm në aktvendim, por nuk mund të jenë pjesë e tij (shih ASC-09-0075, ASC-09-0108, ASC-10-0023, ASC-10-0036, et al).

Sipas nenit 11 të RREG 2008/4 dhe nenit 66 të UA 2008/6, Trupi Gjyqësor merr vendim lidhur me shpenzimet e bëra gjatë procedurës në shkallën e parë dhe Kolegji i Ankesave – kur vendos për një lëndë përfundimisht – lidhur me shpenzimet e bëra gjatë procedurave në të dyja shkallët.

Në bazë të nenit 57.2 të UA UNMIK-ut 2008/6 Dhoma e Posaçme ka lëshuar Rregullat Plotësuese Procedurale lidhur me Taksat Gjyqësore. Aty thuhet kështu:

‘Neni 10 i Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/2 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 27.11.2008, lidhur me ‘‘Tarifat e Taksave Gjyqësore’’ – me specifikimet e mëposhtme – shpallet të jetë i aplikueshëm për procedurat gjyqësore para DHPGJS-së.

Neni 10.9 deri te neni 10.23 janë të aplikueshëm – mutatis mutandis – për procedurën e ankimeve para Trupit Gjyqësor dhe para Kolegjit të Ankesave.

Si sqarim, neni 10.11 është i aplikueshëm edhe për procedurën që drejton ankimin kundër aktvendimeve të shkallës së dytë të Trupit Gjyqësor.

(...)

Këto rregulla hyjnë në fuqi më 30 qershor 2010, duke ndryshuar Rregullat Plotësuese Procedurale lidhur me Taksat Gjyqësore të datës 10 mars 2010.

Ato mbulojnë dhe zbatohen edhe për të gjitha veprimet e DHPGJS-së nga data 1 janar 2010, sipas rastit, dhe vlejné deri më 31 dhjetor 2010.'

Taksat gjyqësore në të dyja shkallët përbëhen nga, në njërin anë një taksë për ushtrimin e parashtresës(ave), në anën tjetër nga një taksë për lëshimin e (një) aktvendimi(eve).

Pasi që aktvendimi në shkallën e parë është lëshuar përpara ditës së hyrjes në fuqi të rregullave të lartpërmendura, këtu do të shqyrtohen vetëm taksat gjyqësore për procedurën e ankimeve:

Shuma e taksës për ushtrimin e ankesës siç rregullohet me nenin 10.11 të Urdhëresës Administrative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. 2008/2 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore ("ADJ") është 30,-- Euro.

Neni 10.15 ADJ përcakton se për aktvendimet për hedhjen poshtë të padive (si të papranueshme) duhet të paguhet vetëm gjysma e taksës të rregulluar në nenin 10.1 ADJ (që parimisht i bazon taksat gjyqësore në vlerën e padisë), deri në shumën maksimale prej 30,-- Euro. Kjo vlen edhe për aktvendimet në shkallën e dytë (neni 10.21 ADJ i referohet neneve 10.12 deri 10.18 ADJ). Neni 10.15 në lidhje me nenin 10.21 përfshin aktvendimet në shkallën e dytë që hedhin poshtë ankesat si të papranueshme, si dhe aktvendimet mbi ankesat kundër aktvendimeve të shkallës së parë që nuk i prekin meritat e lëndës.

Përveç kur vlera e padisë dëshmohet të jetë më e vogël (në shkallën e parë nga paditësi, në shkallën e dytë nga ankuesi), sipas nenit 10.1 në lidhje me nenet 10.15 dhe 10.21, taksa gjyqësore është 30,-- Euro.

VI

Në lëndën në fjalë, as në shkallën e parë e as në shkallën e dytë nuk janë bërë deklaratimet për vlerën e padisë si më të vogël. Prandaj, taksa gjyqësore për aktvendimin në shkallën e dytë është përcaktuar 30,-- Euro.

Në përgjithësi, për procedurat e ankimeve vlejnë taksat gjyqësore në vijim:

Tarifat e taksave gjyqësore, neni 10.11 (ushtrimi i ankesës)	30 Euro
Tarifat e taksave gjyqësore, neni 10.15 lidhur me 10.21 dhe 10.1 (aktvendimi në shkallën e dytë)	30 Euro
Gjithsej	60 Euro

Këto taksa gjyqësore do të barten bashkërisht nga Ankuesit.

Pas caktimit, Ankuesit kanë të drejtë që në çdo kohë të kontrollojnë shkresat e lëndës në lokalet e DHPGJS-së.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues i EULEX-it _____

Torsten Koschinka, Gjyqtar i EULEX-it _____

Mr.sc.Sahit Sylejmani, Gjyqtar _____

Tobias Lapke, Regjistruer i EULEX-it _____